

Syllabus i lëndës

Lënda: Letërsi shqipe

Programi i studimit: Teologji

Numri i ECTS kredive: 3 ECTS Kredi

Niveli dhe lloji i lëndës: Zgjedhore

Kodi i lëndës: 211

Fondi i orëve: 2 + 0

Qëllimi i lëndës

Nëpërmjet lëndës **Letërsi shqipe** studentët do t'i zgjerojnë njohuritë dhe do t'i thellojnë ato më mirë e më drejtpërdrejt, duke mësuar për veprat e ndryshme artistike e shkencore të autorëve shqiptarë që nga fillimet e shkrimit shqip me deri në periudhën e Pavarësisë së shtetit shqiptar. Pra, ky kurs do t'iu ofrojë studentëve lëndë të bollshme nga fusha e letërsisë shqipe.

Ky kurs do t'i vërë në dijeni studentët me aspektet, dukuritë dhe temat e ngjarjet e trajtuara në veprat e autorëve shqiptarë, duke filluar nga humanizmi e renesanca, dokumentet e para të shkrimit shqip, për të vazhduar pastaj me autorët e letërsisë së vjetër shqipe, kurse një vëmendje e posaçme do t'iu kushtohet shkrimtarëve që shkruan me alfabetin arab, sikundër janë: Ibrahim Nezimi, Hasan Zyko Kamberi, Sylejman Naibi, Muhamet Çami etj. Kaptinë interesante për vlerat ideo-artistike dhe rëndësinë edukative e shoqërore do të jenë emrat e krijuesve të Rilindjes Kombëtare, si: Jeronim de Rada, Naim Frashëri, Sami Frashëri, Zef Serembe etj. Më tej ky kurs do t'i vërë në dijeni studentët me aspektet, dukuritë dhe temat e ngjarjet e trajtuara në veprat e autorëve shqiptarë, duke filluar që nga Shpallja e Pavarësisë së shtetit shqiptar e për të vijuar me ata që i takojnë periudhës së pas Luftës së Dytë Botërore e deri në ditët e sotme. Vëmendja do të përqendrohet tek autorët më të rëndësishëm të këtij shekulli të zhvillimit të letërsisë shqipe, sikundër janë: Gjergj Fishta, Ibrahim Dalliu, Asdreni, Fan Noli, Migjeni, Hafiz Ali Korça, Lasgush Poradeci, Esad Mekuli, Adem Demaçi, Kasëm Trebeshina, Jakov Xoxa, Dritëro Agolli, Ismail Kadare etj.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje:

- a) të njohin vlerat kryesore të letërsisë së vjetër shqipe dhe të asaj të Rilindjes Kombëtare;
- b) të dallojnë procesin e evoluimit të letërsisë shqipe nga një letërsi qarqesh të kufizuara në një letërsi kombëtare;
- c) të aftësohen për të interpretuar idetë, pikëpamjet, vlerat dhe rëndësinë gjuhësore, historike, edukative dhe artistike të veprave të krijuesve shqiptarë të këtyre periudhave;
- d) të njohin rolin e përgjithshëm emancipues të letërsisë shqipe në procesin e krijimit të vetëdijes kombëtare;
- e) të zhvillojnë aftësitë shprehëse duke pasur për model veprat më të arrira të letërsisë shqipe etj. të njohin vlerat kryesore të letërsisë së shqipe;
- f) të dallojnë veçantitë kryesore stilistike të individualiteteve të shquara letrare shqiptare;
- g) të aftësohen për të interpretuar idetë, pikëpamjet, vlerat dhe rëndësinë gjuhësore, historike, edukative dhe artistike të veprave të autorëve letrarë shqiptarë;
- h) të vlerësojnë rolin e përgjithshëm të letërsisë shqipe për prezantimin e kulturës shqiptare në botë;
- i) të zhvillojnë aftësitë shprehëse duke pasur për model veprat më të arrira të letërsisë shqipe etj.

Metodologjia e mësimdhënies:

Realizimi i mësimdhënies do të zhvillohet nëpërmjet trajtimit të temave, motiveve, ngjarjeve me metoda adekuate, të cilat do të sigurojnë të dhëna relevante drejt analizave, shqyrtimeve, vështrimeve dhe konstatimeve përkitazi me strukturën e veprave. Në këtë kontekst, si forma të punës në interpretimin e përmbajtjeve të veprave do të jenë ligjëratat e rregullta, esetë, ushtrimet, diskutimet, puna në grupe dhe, për të gjitha këto, do t'i ftojme në ndihmë teknika dhe metodat e reja.

Përmbajtja e lëndës:

Java I

- Prezantim i përgjithshëm i përmbajtjes së lëndës

- Aspekteve të periodizimit të letërsisë shqipe.
- Literatura: Grup autorësh, Historia e letërsisë shqiptare
- Kultura shqiptare në mesjetë dhe fillimet e shkrimit shqip (Dokumentet e para të shkrimit shqip)
- Humanistët e parë shqiptarë (Marin Barleti: “Historia e Skënderbeut”)
Literatura: Grup autorësh, Historia e letërsisë shqiptare f. 22-31.
Mr. Fadil Grajçevci, “Historia e Skënderbeut” e Marin Barletit dhe kultura shqiptare në shekullin XV, 1998.
Ushtrim në të shprehur: ese

Java II

- Letërsia e vjetër shqipe (Gjon Buzuku, Pjetër Budi, Frang Bardhi dhe Pjetër Bogdani)
- Literatura: Grup autorësh, Historia e letërsisë shqiptare f. 32-49
- Alamiada shqiptare
- Ibrahim Nezimi
Literatura: Grup autorësh, Historia e letërsisë shqiptare f. 60-77.

Java III

- Hasan Zyko Kamberi
- Sulejman Naibi
Literatura: Grup autorësh, Historia e letërsisë shqiptare f. 60-77.
- Muhamet Kyçyku – Çami
- Zenel Bastari dhe bejtexhinj të tjerë
Literatura: Grup autorësh, Historia e letërsisë shqiptare f. 60-77.
Ushtrim në të shprehur: ese

Java IV

- Letërsia arbëreshe e Rilindjes: Jeronim de Rada
Literatura: Grup autorësh, Historia e letërsisë shqiptare f. 232-285.
- Gavriil Dara i Ri
- Zef Serembe
Literatura: Grup autorësh, Historia e letërsisë shqiptare f. 294-322.

Java V

- Letërsia në Shqipëri në vitet 30-70 të shekullit XIX
Literatura: Grup autorësh, Historia e letërsisë shqiptare f.; 133-148.
- Sami Frashëri – *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhet*
Literatura: Grup autorësh, Historia e letërsisë shqiptare f. 163-174.

Ushtrim: Analizë e tekstit letrar

Java VI

- Naim Frashëri – krijimtaria letrare dhe vlerat e saj
- Literatura: Rexhep Qosja, Histori e letërsisë shqipe – romantizmi III.
- Ndre Mjeda: Jeta dhe vepra
Literatura: Grup autorësh, Historia e letërsisë shqiptare, f. 339-363.
Ushtrim: Analizë e tekstit letrar

Java VII

- Autorë të tjerë të Rilindjes Kombëtare
- Literatura: Grup autorësh, Historia e letërsisë shqiptare, f. 383-417.

Hafiz Ibrahim Daliu, vepra letrare

Literatura: Hysen Matoshi, Vepra letrare e Hafiz Ibrahim Dalliut, Buletini i Fakultetit të Studimeve Islame, nr. 3/2014, Prishtinë, 2014, f. 33-51.

Ushtrim: Analizë e tekstit letrar

Java VIII

- Gjergj Fishta, jeta dhe vepra
- Lahuta e Malcis
Literatura: Robert Elsi, Historia e letërsisë shqiptare, f.283-304.

Kollofiumi

Java IX

- Asdreni, jeta dhe vepra
Literatura: Grup autorësh, Historia e letërsisë shqiptare, f. 418-440.
- Fan S. Noli: Albumi
- Literatura: Grup autorësh, Historia e letërsisë shqiptare, f. 483-519.

Ushtrim në të shprehur: ese

Java X

- Migjeni: Vargjet e lira
- Literatura: Grup autorësh, Historia e letërsisë shqiptare, f. 542-566.
- Lasgush Poradeci – jeta dhe vepra
Literatura: Grup autorësh, Historia e letërsisë shqiptare, f. 521-530.

Java XI

- Hafiz Ali Korça: Shtatë ëndrrat e Shqipërisë; Jusufi me Zelihanë
- Mevludi i Hafiz Ali Korçës
Literatura: Ismail Ahmedi, Hafiz Ali Korça, jeta dhe vepra, f.167-247.
Ushtrim: Analizë e tekstit letrar

Java XII

- Rrymat letrare pas mbarimi të luftës së Dytë Botërore
Literatura: Agim Vinca, Alternativa letrare shqiptare
- Letërsia shqipe në ish-Jugosllavi
- Esad Mekuli: Për ty
- Literatura: Robert Elsi, Historia e letërsisë shqiptare, f. 435-460.

Java XIII

- Adem Demaçi: Gjarpinjtë e gjakut
- Kasëm Trebeshina: Promemoria, Stina e stinëve
- Literatura: Robert Elsi, Historia e letërsisë shqiptare, f. 403-405 dhe f. 435-460.
- Jakov Xoxa: Lumi i vdekur
- Literatura: Robert Elsi, Historia e letërsisë shqiptare, f. 382.
Ushtrim: Analizë e tekstit letrar

Java XIV

- Dritëro Agolli, poezia dhe proza
- Literatura: Robert Elsi, Historia e letërsisë shqiptare, f.406-408 dhe f.418-420.
- Ismail Kadare, proza dhe poezia
- Literatura: Robert Elsi, Historia e letërsisë shqiptare, 386-401.
Ushtrim: Analizë e tekstit letrar

Java XV

- Rexhep Qosja, Vepra shkencore dhe letrare
- Hysen Matoshi, Qasje albanologjike, f. 77-121.
- Drama e sotme shqipe

- Literatura: Robert Elsi, Historia e letërsisë shqiptare, f. 429-434 dhe 458-460.

Kriteri dhe komponentët e vlerësimit:

Studentët do të përcillen me interesim si në ligjërata ashtu edhe në punën e bërë në bibliotekën e fakultetit.

Në vlerësim do të merren parasysh kriteret që çojnë te objektiviteti i njëmendtë.

- Njohuritë për lëndën..... 40 %
- Interpretimi tekstit letrar..... 30 %
- Detyrat e shtëpisë dhe angazhimet plotësuese: ...20 %
- Ndjekja e ligjëratave: 10 %
- Gjithsej: 100 %

Standardi i notimit në FSI:

10= 90% - 100%

9 = 80 – 89

8 = 70 – 79

7 = 60 – 69

6=50 - 59

Literatura obliguese:

1. Grup autorësh, Historia e letërsisë shqiptare, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i AShSh, Rilindja, Prishtinë, 1983.
2. Robert Elsi, Historia e letërsisë shqiptare, Dukagjini, Pejë, 1997.
3. Mr. Fadil Grajçevci, “Historia e Skënderbeut” e Marin Barletit dhe kultura shqiptare në shekullin XV, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1998.
4. Rexhep Qosja, Histori e letërsisë shqipe – romantizmi I, II, III, Rilindja, Prishtinë, 1984-1986.
5. Ismail Ahmedi, Hafiz Ali Korça, jeta dhe vepra, Logos A, Shkup, 2008.
6. Hysen Matoshi, Vepra letrare e Hafiz Ibrahim Dallit, Buletini i Fakultetit të Studimeve Islame, nr. 3/2014, Prishtinë, 2014, f. 33-51.
7. Hysen Matoshi, Qasje albanologjike, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2016, f. 77-121.

Aktiviteti	Orë	Javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Ushtrime në teren			
Kollokfiume, seminare,ese	1	5	5
Detyra të shtëpisë	1	5	5
Koha e studimit vetanak të studentit (në	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	2	5 ditë	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim	1	5 ditë	5
Projektet, prezantimet, etj.			
			Ngarkesa
			Orë 90